


ACT4PRESPA - Vepro për Prespën**Duration:** 17.05.2024 - 16.05.2027**Countries:**
North Macedonia**EU contribution:** € 399 060**Total budget:** € 443 400**Implementer:**

NI Institute and museum – Bitola, North Macedonia, Civil Society Organization for development of Alternative tourism LJUBOJNO, Ljubojno village North Macedonia,

**Social media:**

facebook.com/act4prespa, instagram.com/act4prespa/

Project description:

“ACT4PRESPA – Vepro për Prespën” është një projekt ndërkufitar i trashëgimisë kulturore i dedikuar mbrojtjes, promovimit dhe vlerësimit të qëndrueshëm të trashëgimisë kulturore dhe natyrore të rajonit të Liqenit të Prespës në Maqedoninë e Veriut, Greqi dhe Shqipëri. Adreson sfidat e përbashkëta mjedisore, sociale dhe ekonomike, duke forcuar bashkëpunimin rajonal dhe duke mbështetur zhvillimin e qëndrueshëm social dhe ekonomik, bazuar në ruajtjen e kulturës dhe të trashëgimisë.

Aksioni kombinon kërkimin arkeologjik, aktivitetet e konservimit, inovacionet digjitale dhe angazhimin publik, me qëllim mbrojtjen e trashëgimisë kulturore të prekshme dhe të paprekshme. Ndërhyrjet kryesore përfshijnë kërkimin e parë arkeologjik nënujor në Liqenin e Prespës, punimet e konservimit në ndërtesën historike Saraj në Resnjë dhe në afresket në kishën e Shën Paraskevës në fshatin Brajçino, si dhe dokumentimin dhe vlerësimin e traditave gojore, shprehjeve dhe të mirave kulturore lokale.

Po ashtu, projekti promovon përdorimin e teknologjive digjitale për të përmirësuar qasjen publike në trashëgimi përmes zhvillimit të hartës kulturore interaktive 3D dhe digjitalizimit të përmbajtjes kulturore. Përmes ekspozitave, aktiviteteve edukative, ngjarjeve të rrjetëzimit dhe shkëmbimeve profesionale, “ACT4PRESPA” synon të forcojë

Expected results:

- Kërkime arkeologjike nënujore që kontribuojnë në thellimin e njohurive dhe në dokumentimin e ri të trashëgimisë kulturore të zhytur në rajonin e liqenit të Prespës;
- Monumete të rëndësishme të trashëgimisë kulturore të ruajtura dhe të mbrojtura, duke përfshirë Sarajin në Resnjë dhe kishën “Shën Paraskeva” në fshatin Brajçino;
- Elemente të prekshme dhe të paprekshme të trashëgimisë kulturore të rajonit të Prespës, të identifikuara, të dokumentuara dhe të vlerësuara;
- Janë ndërtuar harta interaktive 3D të trashëgimisë kulturore dhe përmbajtje digjitale, me qëllim përmirësimin e qasjes publike dhe të dukshmërisë së të mirave kulturore të Prespës;
- Kapacitetet e profesionistëve të kulturës, nxënësve dhe institucioneve partnere janë forcuar përmes trajnimeve, rrjetëzimit dhe aktiviteteve të përbashkëta;
- Ndërgjegjësimi publik dhe bashkëpunimi rajonal për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore dhe turizmin e qëndrueshëm kulturor janë rritur përmes ekspozitave, ngjarjeve dhe fushatave promovuese.